



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1156 Prot.

Vlorë, më 15/06/2023

Lënda : *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i sekuestros)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

- Drejtoria e Burimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të një akti administrativ – Vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore si vijon :

- Nr.1518 Prot., datë 24/05/2023, i materializuar për subjektin “Ndriçim Hitaj” p.f, me ID. G806090790, me banim në Vlorë (Rruga “Kastriot Gjini”, nr.47, hyrja 2, apartamenti 12, KP 9401).

Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit administrativ të lartcitur, i cili përbëhet prej 2 (dy) fletë.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes së aktit të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
Artan Bedinaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1518..... Prot.

Vlorë, më 24/05/2023

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori, subjekti “Ndriçim Hitaj” p.f me ID G806090790, me banim në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.20, me Nr.637/3 Prot., datë 27/03/2023, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 7.940 (Shtatë mijë e nëntëqind e dyzetë) lekë, bazuar në nenin 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave, V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, ndaj subjektit debitor “Ndriçim Hitaj” p.f, me ID. G806090790, me banim në Vlorë (Rruga “Kastriot Gjini”, nr.47, hyrja 2, apartamenti 12, KP 9401).

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Ndriçim Hitaj” p.f, me ID. G806090790, me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.1029 Prot., datë 04/04/2023, me lëndë “Njoftim Vendimi”. Gjithashtu, ky vendim është njoftuar edhe me anë të lajmërimit publik, me shkresën Nr.1059 Prot., datë 05/04/2023 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, e cila ka kryer shpalljen publike në websit-in e saj në kolonën “Njoftime” (me shkresën e saj Nr.6347 Prot., datë 11/04/2023); me shkresën nr.1060 Prot., datë 05.04.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrative (Vendimet e.. kontabilizimit)”, drejtuar Bashkisë Vlorë; me shkresën nr.1061 Prot., datë 05.04.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e.. kontabilizimit)”, drejtuar Prefekturës së Qarkut Vlorë, e cila ka konfirmuar shpalljen publike me shkresën e saj Nr.371/1 Prot., datë 18.04.2023 me lëndë “Mbi Shpalljen Publike të aktit administrativ me nr....”. Gjithashtu, vendimi i është njoftuar subjektit edhe me anë të komunikimit telefonik.

Personi fizik natyror “Ndriçim Hitaj” p.f, me ID. G806090790, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.20, me Nr.637/3 Prot., datë 27/03/2023, si

dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.20, me Nr.637/3 Prot., datë 27/03/2023, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Ndriçim Hitaj” p.f, me ID. G806090790, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit fizik natyror - “Ndriçim Hitaj” p.f, me ID. G806090790, apo garantuesit/garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit fizik natyror - “Ndriçim Hitaj” p.f, me ID. G806090790, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi fizik natyror - “Ndriçim Hitaj” p.f, me ID. G806090790, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 7.940 (Shtatë mijë e nëntëqind e dyzetë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor Nr.20, me Nr.637/3 Prot., datë 27/03/2023, të Degës së Doganës Vlorë.

KRYETAR
Artan Bedinaj

